

VENDIM
Nr. 717, datë 24.11.2021

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
TË PËRFAQËSUAR NGA DREJTORIA E SHIFRËS SË MINISTRISË SË
MBROJTJES, DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS,
TË PËRFAQËSUAR NGA DEPARTAMENTI I MBROJTJES, AGJENCIA E
SIGURISË KOMBËTARE/SHËRBIMI QENDROR I SIGURISË, DREJTORIA E
SIGURISË KIBERNETIKE DHE AGJENCIA E SHPËRNDARJES DHE
KONTABILITETIT TË KOMISIONIT USHTARAK, NATO (DACAN), NË LIDHJE
ME DHËNIEN E PAJISJEVE DHE SHËRBIMEVE TË SIGURISË PËR
KOMUNIKIMIN, NË KUADRIN E INFRASTRUKTURËS MENAXHERIALE TË
KODUAR NË ORGANIZATËN E TRAKTATIT ATLANTIK VERIOR (NATO KMI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Drejtoria e Shifrës së Ministrisë së Mbrojtjes, dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga Departamenti i Mbrojtjes, Agjencia e Sigurisë Kombëtare/Shërbimi Qendror i Sigurisë, Drejtoria e Sigurisë Kibernetike dhe Agjencia e Shpërndarjes dhe Kontabilitetit të Komisionit Ushtarak, NATO (DACAN), në lidhje me dhënien e pajisjeve dhe shërbimeve të sigurisë për komunikimin, në kuadrin e infrastrukturës menaxheriale të koduar në Organizatën e Traktatit Atlantik Verior (NATO KMI), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj